



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TROPOJE  
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 3527/5 prot.

B. Curri, më 10.09.2025

**VENDIM**

**Nr 46 Date 04.09.2025**

**PËR MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TE VEPRIMIT TE BARAZISE GJINOR  
TË BASHKISË TROPOJË 2025–2027**

Këshilli Bashkiak i Tropojës, mbështetur në: Nenin 54 dhe 55 të Ligjit Nr 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, Ligjin nr. 9970, datë 24.7.2008, “Për barazinë gjinore në shoqëri”, i ndryshuar; Ligjin nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”; Ligjin nr. 10221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi” i ndryshuar; Strategjinë Kombëtare për Barazi Gjinore 2021–2030, miratuar me VKM nr. 400, datë 30.6.2021; Udhëzimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për integrimin e çështjeve gjinore në dokumentet e planifikimit vendor; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 348, datë 11.06.2020, “Për miratimin e mekanizmit të koordinimit për barazinë gjinore në nivel vendor dhe qendror”; Programin për Reforma në Administratën Publike 2022–2030; Udhëzimet dhe rekomandimet e INSTAT dhe Zyrës së Koordinatorit Vendor për Barazinë Gjinore;

Duke u bazuar në propozimin e Kryetarit të Bashkisë Tropojë dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit shoqëruës dhe projektit të Planit Vendor të Barazise Gjinore 2025–2027, që synon të integrojë perspektivën gjinore në të gjitha fazat e politikëbërjes dhe ofrimit të shërbimeve publike, të përmirësojë mekanizmat e llogaridhënies dhe të forcojë mbrojtjen e të drejtave të grave, vajzave dhe grupeve të marginalizuara.

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Planit të Veprimit të Barazise Gjinore i Bashkisë Tropojë për periudhën 2025–2027, si një instrument strategjik që synon përfshirjen efektive të barazisë gjinore dhe ndërtimin e një administrate vendore transparente, të ndershme, gjithëpërfshirëse dhe me integritet të lartë.
2. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Sociale, në bashkëpunim me Koordinatorin Vendor për Barazinë Gjinore, të ndjekë zbatimin e këtij plani dhe të raportojë periodikisht për progresin në Këshillin Bashkiak.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, (i ndryshuar).

Shpallur me 08.09.2025, Miratuar me 13 Vota, Vota 13 Pro, Vota 0 Kunder, Vota 0 Abstenim

SEKRETARI  
Ergent GJONGECAJ



KRYETARI  
Arber ÇAKRAJ